



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 12 shtator 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON –auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri- koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.08.2011.
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2010– Zyra e Auditorit të Përgjithshëm,
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Valbona Dibra - Propozoi që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i raportit përfundimtar të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr.03/L075.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Rendin e ditës me propozimin e deputetes Valbona Dibra.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25.08.2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.08.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2010– Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi – Raporti vjetor i auditimit është raport gjithëpërfshirës i auditimit. Tri çështje janë të cilat duhet analizuar në mënyrë më të theksuar: trajtimi i aseteve – nuk janë trajtuar në bazë të kërkesave ligjore-përrjashtim ka këtu Dogana e Kosovës. Në të gjitha raportet ka probleme mënyra e prokurimit e cila kërkon një koment dhe një analizë të detajuar. Komisioni duhet të mbajë një seancë dëgjimore ku do të duhej ftoj ministrin e financave dhe kryetarin e Bordit të KRPP-së, për shqyrtim më të detajuar të këtyre të gjeturave. Aty ku ka funksionuar auditimi i brendshëm, problemet janë më të vogla. Komisioni ka qenë fleksibil në trajtimin e disa çështjeve, por disa çështje janë shumë shqetësuese.

Lars Lage OLOFSSON –auditor i përgjithshëm – Në këtë vit ZAP ka dhënë “Opinion të Pakualifikuar” në pasqyrat vjetore financiare për Buxhetin e Kosovës. Kjo domethënë që i tërë raportimi i jashtëm është i mirë. ZAP ka adresuar disa mangësi në raportim si: *pasuritë-asetet-kërkesat për këto pasuri dhe mënyra se si ato raportohen është çështje që shtrohet që nga viti 2005. Gjëja kryesore është se çka do të kërkoj Kuvendi nga Qeveria për hapat e mëtutjeshëm. Ka dallime në pasqyrat individuale buxhetore dhe ato të Buxhetit të Kosovës - kjo nuk ka ndikim fundamental në pasqyrat financiare, por e komplikon në një kornizë afatmesme vendimet politike. p.sh ministria e FSK-së, ka ndikuar mbi 140milion euro për pasuri, në pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës kanë pak më shumë se 12. Kjo është një diferencë shumë e madhe. ZAP ka një listë ku janë të shprehura dallimet dhe kjo ka qenë një gjë për të cilën edhe vet ka menduar gjatë se si ta jap një opinion me theksim të çështjes, sepse kjo është shumë me rëndësi për situatën e buxhetit tani.*

Sistemi SIMFK ku të gjithë duhet të regjistrojnë pasuritë e tyre - shumë prej shpenzuesve buxhetore regjistrojnë pasuritë në një fletë të EXEL-it, në një pjesë e Qeverisë, përkatësisht MAP në emër të Qeverisë, ndërton sistemin e brendshëm për regjistrimin e pasurisë që njihet sistemi i “E Pasurisë”. Në këtë sistem modern elektronik të gjitha rreziqet që dalin kur përdorim një program si “EXEL” me këtë program ato tejkalohen. Problemi qëndron në atë se sistemi i zhvilluar në një anë dhe që ka Qeveria në anën tjetër, në një farë mënyre këto dy sisteme nuk komunikojnë. Informata nuk dërgohet nga një sistem në tjetrin. Ky është një lloj burimi për gabime. Kjo është një çështje që Kuvendi duhet tja drejtoj Qeverisë për të ndjekur një zgjidhje më racionale, sepse kjo kushton para. Në këtë drejtim Qeveria duhet t’i ndihmoj shpenzuesit buxhetor që të gjejë zgjidhje të lehta.

Çështje tjetër e rëndësishme është se si Organizatat Buxhetore i shpalosin detyrimet e papaguara – qëllimi i sistemit të Qeverisë është që të kaloj nga sistemi para të gatshme, pra më shumë nga ana e sistemit aktual që do ta lehtësonte planifikimin e buxhetit. Nëse nuk e dini sa shumë ka detyrime të papaguara në nivel të shpenzuesve buxhetor edhe në nivel qendror, atëherë kur merren vendime në Kuvend nuk dihet sa është shuma e parave e cila veç se është zotuar. Mangësia tretë e rëndësishme në aspektin e cilësisë është - mungesa e raportimit operacional në procesin buxhetor. Kemi pas këtë vit LMFP që nga viti 2008 dhe tani pas tre vitesh nuk mund të shohim raportet operationale në procesin e buxhetit. Kur janë diskutuar raportet e OB, Komisioni ka parë si një lloj shablloni të ngjashëm, sepse ka pas gjëra të njëjta për shumicën prej tyre, si prokurimi që është një brengë e madhe për të gjithë. Trendi i shpenzimit të parasë në fund të vitit. Këtë vit ka qenë pak më ndryshe, për shkak të projektit të madh të rrugës.

Sistemi i brendshëm i auditimit - sfida në këtë drejtim është, programi i investimeve publike. Ideja për të pasur një sistem - e bënë më të parashikueshme dhe më të lehtë për vendimmarrësit që të planifikojnë. Pra, gjatë vendimeve me prioritet të shohin se çka është zotuar. Mënyra se si shpenzuesit buxhetor e përdorin këtë sistem, lënë vend për përmirësim e sidomos në Komuna.

Ligji për shërbyesit civil dhe Ligji për pagat- Qeveria është përgjegjëse për legjislacionin sekondar. Ritmi se si është kryer kjo punë është në mënyrë të habitshme ka shkuar ngadalë. *Menaxhimi i buxhetit në disa institucione më specifike*- institucionet e pavarura, shohim problemet e përgjithshme, domethënë roli i tyre është që në emër të Kuvendit të siguroj tregun dhe jetën e njerëzve – pra ata duhet të sigurojnë që janë dhënë koncesionet si duhet. Duke bërë këtë është esenciale që këto institucione të pavarura të jenë tërësisht të pavarura. Kjo nuk ndodhë realisht. Është shumë me rëndësi se si Kuvendi do të jap shtytje punës së këtyre institucioneve. Problemi është se Ligji thotë një gjë, ndërsa praktika diçka tjetër. Legjislacioni sekondar ka komplikuar edhe më shumë situatën.

Komunat - cilësia e informatave po përmirësohet për pasqyrat financiare, por mënyra se si ata i ofrojnë shërbimet për qytetarët ka nevojë për përmirësim. Sfidë më e madhe për komunat është kanë nevojë për një shef ekzekutiv i cili kryen punët dhe politika ka një arsye pse kjo është larguar në vitin 2007, por efekti nuk shihet si pozitiv dhe Kuvendi duhet të marrë në konsideratë që kjo situatë të përmirësohet.

Në fushën e ndërmarrjeve publike dhe të privatizimit - problemi është i ngjashëm me komunat. Shërbimi i ofruar qytetarëve nuk është i cilësisë së mirë. Mënyra se si shteti si pronar dhe komuna si pronar apo edhe Bordet mbikëqyrëse, të gjithë menaxheret ekzekutiv po merren me sfidat të cilat i kanë në shërbim të qytetarët, ka nevojë që në të gjitha nivelet të zhvillohet një model i llogaridhënies. Kur bëhet fjalë për privatizimin Kuvendi ka vendosur ambicie mjaft të mëdha, pra ritmi sidomos i likuidimit duhet të përshpejtohet dhe AKP duhet të punoj në një mënyrë më ndryshe.

Armend Zemaj – Ndau mendimin pozitiv sa i përket pasqyrimit të pasqyrave të audituara edhe pse akoma mbetet shqetësim i madh menaxhimi i pasurisë, parasë publike dhe i rregullsisë. Është shqetësuese që nga 81 auditime vetëm 14 prej tyre janë të pakualifikuara, ndërsa të gjitha të tjerat tregojnë një gjendje reale dhe nuk dallon nga progresi në vitin 2009 në shumë sfera, edhe pse në raport prezantohet si progres. Është e pa-tolerueshme dhe është shumë shqetësuese që kemi 9 mohime të opinionit dhe tri të kundërta. Kjo domethënë se këto institucione- komuna nuk japin llogari për shpenzimin e parasë publike. Kuvendi duhet të shikoj se pse nuk po respektohet ligji dhe të ndërmerren veprimet e caktuara. Ligji për Shërbyesit Civil dhe Ligji për paga nuk po zbatohet-kjo tregon se në OB nuk është në pyetje vetëm nepotizmi, por edhe mosrespektimi i procedurave, nga kjo derivon mos efikasitet për punët e bëra. Dallimi i madh në nivelin e pagave e sidomos të Bordet e pavarura, ndërmarrjet publike, por edhe në nivelin qendrorë, kjo është shqetësuese. Menaxhimi i buxhetit dhe i shpenzimeve tregon se ky komisioni duhet të kujdeset të kryej detyrën e vet dhe njerëzit të vihen para përgjegjësisë.

Komunat e reja serbe - sipas raportit është shqetësuese mos funksionimi i NJAB dhe mosparaqitja e tabelave kjo tregon se këto komuna nuk japin llogari për shpenzimin e parasë publike. Duhet ndihmuar këto komuna, mirëpo veprimet duhet të merren parasysh. Shumica e rekomandimeve nuk janë implementuar fare dhe kjo tregon se mungon llogaridhënia në institucionet e Kosovës. Komisioni duhet të ketë rekomandime të qarta dhe me një pasqyrë reale të dal para Kuvendit.

Ramiz Lladrovci – Komisioni po shqyrton Raportin vjetor gjithëpërfshirës të auditimit për të cilën Kuvendi duhet të shpreh qëndrim deri më 31 tetor. Komisioni deri më tani ka shqyrtuar një numër të madh të raporteve dhe ka mbikëqyrur rekomandimet për veprimet e ndërmarrja. Në përgjithësi u pajtua me raportin vjetor dhe vërejtjet janë paraqitur gjatë shqyrtimit të raporteve individuale. Komisioni është kujdesur që mos të ndërhyjë në punë e ZAP-it dhe është pajtuar në përgjithësi me ato raporte. A ka përmirësim të pasqyrimit të pasqyrave financiarë të OB-ve, apo ka kthim prapa? Cilat janë fenomenet që po përsëriten më shpesh dhe si të evitohen ato?

ZAP disa herë është deklaruar se ka flamujt e kuq. A keni marrë përgjigje për këta flamujt e ngritur?

Alma Lama – Sipas raportit tek shkaktarët shpjegohet se nuk bëhet fjalë që këto gabime janë bërë në mënyrë të qëllimshme, por në mungesë të të kuptuarit të ligjit apo flitet për një mjedis të

dobët kontrolli. Pyeti: A mund të thuhet se gabimet bëhen në mënyre të qëllimshme, sepse ka interesa të caktuara prapa tyre? Dhe të mos mbetet konstatimi në raport se kjo është si pasojë e mos-kuptuarit të gjërave.

Pyeti: pse nuk ka një sistem të penalizimit për keq-menaxhim? Dhe çfarë rekomandon ZAP-i lidhur me këtë? Kjo lidhur me MF.

Albert Kinolli – Përgëzoi ZAP-in për punën e bërë dhe pyeti: rekomandimi që ka të bëjë me Kuvendin – se duhet të krijoj kushte më të mira të mundshme për implementimin e procesit të privatizimit dhe po-ashtu u tha se AKP duhet të punoj më ndryshe. Pyeti: cilat janë ato kushte që duhet të plotësoj Kuvendi dhe si duhet të punoj AKP, e që nuk e ka aplikuar deri më tani

Valbona Dibra – “Opinionimi është i pakualifikuar”. Çka do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Kosova është shtet i ri dhe më gëzon faksi që ZAP dhe të rinjtë e Kosovës kanë arritur të përpilojnë një raport shumë profesional. Asnjë shtet dhe asnjë institucion nuk është i përkryer, por për një shtet të ri si Kosova kjo është gjë e mirë. Megjithatë ka vend për përmirësime. Komisioni së bashku me ZAP-in duhet të vazhdoj që të ndikoj në edukimin e OB-ve, në përmirësimin e menaxhimit dhe përmirësimit të punës.

Adem Grabovci – Ishte i mendimit se më tepër duhet marrur me preventiven, sesa me pasojën gjë që ka ndodhur deri më tani. Çka po i shkakton këto pasoja-Ligji i cili është aktualisht në zbatim apo është faktori njeri që nuk zbaton ligjin. Aty ku ka shkelje ligjore duhet kërkohet përgjegjësia, por kjo mund të ndodhë aty kur konstatohen shkeljet ligjore. Shpenzimi i buxhetit ka tendenca që të zbatohet në fund të vitit. Ligji aktual i prokurimit ka ndikuar që buxheti të shpenzohet në fund të vitit. Pra, ligji nuk duhet të shndërrohet në pengesë e që ka ndodhur me ligjin aktual. Shpresojmë që me ligjin e ri këto probleme do të evitohen. Po ashtu ka probleme të privatizimit - ligji përcakton procedurat dhe aty duhet të ketë qartësi nëse ka respektim të ligjit ose jo dhe çfarë masash duhet ndërmarrë.

Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm – Tani po flasim për Qeverinë dhe po tentojmë ta vendosim Qeverinë para përgjegjësisë se si është shpenzuar buxheti, por deri në një masë mund të thuhet se si Kuvendi i ka organizuar punën për Qeverinë. Duke shikuar se ku janë problemet argumenti për parandalim është shumë i rëndësishëm, por sfidat janë në nivele të ndryshme. Institucionet e pavarura –nëse themi se një problem kryesor është pavarësia e tyre dhe nëse themi se procesi buxhetor për institucionet e pavarura nuk është mirë i ndërtuar dhe themi se atyre duhet krijuar kushte më të mira për të kryer punën. Për Kuvendin a duhet dikush të marr përsyshtë që të vendosë një kërkesë të re për institucione të pavarura që ata duhet të nxjerrin pasqyrat vjetore financiare në një raport operacional së bashku me një opinion të auditimit që në këtë mënyrë t'i jap mundësi Kuvendit që në pranverë të ketë një pamje të përgjithshme për progresin. Kuvendi kështu ka mundësi të diskutoj këto para diskutimit të kornizës afatmesme të shpenzimeve. Ky ishte shembull në vete, për mënyrën se si të ndërtohet sistemi. Por, Kuvendi duhet të ndërmarr disa hapa. Është shuam me rëndësi të ceket se sot ekziston mundësia që menaxherët të marrin masa. Mjetet formale i kanë në dispozicion-pse nuk përdoren kjo është një pyetje që duhet shtruar. Këtu nuk po flasim për keqpërdorim, por për një keqmenaxhim. Të gjithë prokurorët kanë raportet e ZAP-it dhe kanë rreth 20 raste duke hetuar. Rezultatet nuk i dimë, por do t'i përcjellim. Flamujt e kuq - çështja se si AKP mund të punoj më mirë- një prej çështjeve që ka qenë është Ligji i ri për agjencinë dhe kjo është me shumë rëndësi dhe është me shumë rëndësi që Kuvendi të adresoj që kësaj agjencie t'i ofrohen kushtet më të mira që të kryej punën dhe si të sigurohet që të kemi linja të sakta të llogaridhënies, por se si të bëhet kjo, ato pikëpamje janë pjesë e një raporti të veçantë. Por, një gjë është e qartë se procesi i likuidimit është shumë i vonuar. Shkeljet e ligjit- secili e di se kornizat ligjore nuk janë në bazë të të gjitha standardeve. Sipas raportit të progresit Kosova duhet të bëjë disa ligje dhe kjo është shumë për tu bërë që ligjet pastaj të jenë cilësore. Duhet të ketë një lloj përqendrimi se cilat janë gjërat më të rëndësishme.

Ramiz Lladrovci - Nga diskutimi i auditorit të përgjithshëm u përmend “raport i veçantë”. Çka nënkupton kjo raport i veçantë? Komisioni duhet të ketë informata lidhur me këtë.

Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm – ZAP në raport për privatizimin e Sharr-Cem-it, ZAP nuk ka pasur dëshmi për ilegalitet, por mënyra se si është bërë, a janë bërë në pajtim me ligjin dhe përgjigja e ZAP-it ka qenë se dimension i transparencës nuk është zbatuar. Auditimi që po planifikohet për këtë agjenci do të tentoj që të ketë një pikë referimi. Flamujt e kuq nuk ndërlidhen me AKP. Por janë në rastet kur ZAP-i me të vërtet “nuhat” diçka dhe është vështirë të kuptohen arsyet. Çfarëdo që prodhon ZAP është publike dhe ekziston Ligji për qasje në dokumente zyrtare. ZAP nuk ka dokumente sekrete.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike do të vazhdoj në një mbledhje tjetër të Komisionit, me shqyrtimin e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2010, të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, ku të ftuar do të jenë: ministri i Ministrisë së Financave dhe kryetari i bordit të KRPP-së.

4. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr.03/L075

Valbona Dibra – raportuese - Prezantoi raportin përfundimtar të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr.03/L075. Grupi punues ka ardhur në përfundim se Ligji është i zbatueshëm, mirëpo me qëllim të funksionalizimit të mëtejshëm të ZAP- it, ka rekomanduar plotësim ndryshimin e këtij Ligji.

Po ashtu propozoi që Komisioni t’i drejtohet Kryesisë së Kuvendit me kërkesën që të mos bëhet renditja e raportit për shqyrtim në mbledhje plenare nga data 19 shtator 2011 deri më datë 23 shtator 2011, meqenëse Komisioni do të jetë në udhëtim zyrtarë në Parlamentin e Skocisë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që Kuvendit t’i

REKOMANDOJ

- 1. Të shqyrtohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr.03/L075.**
- 2. Arsyetimin eventual për ta përforcuar këtë raport e paraqet deputetja Valbona Dibra, kryesuese e grupit punues.**

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr.03/L075, të mos renditet për shqyrtim në mbledhje plenare nga data 19 shtator 2011 deri më datë 23 shtator 2011.

4. Të ndryshme

Alma Lama – Për ta bërë sa më të mirë procesin e mbikëqyrjes së punë së institucioneve duhet që raportet e punë të shqyrtohen së bashku me raportet e auditimit. Komisioni duhet të mendoj lidhur me këtë se si duhet proceduar tutje.

Valbona Dibra – Tha e LMFPF përcakton afatin kohor për raportim financiar të institucioneve dhe OB. Plani i punës së ZAP nuk ka një afat ligjor se kur do të kryhet një auditim i një OB.

Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm – LMFPF, 31 janari janë draft pasqyrat, 31 mars janë janë pasqyrat vjetore financiare dhe 30 qershor opiniononi i auditimit për pasqyrat vjetore financiare dhe pastaj bazuar në pasqyrat vjetore të audituara, pastaj secila OB para 31 korrikut të dorëzoj një raport për veprimtari ministrit të financave dhe ai do të përgatisë një raport të cilin do t'i dorëzoj Kuvendit para 31 gushtit. Propozoi që të merrni parasysh që në vend të kësaj e sidomos për institucionet që janë përgjegjëse para Kuvendit të keni të njëjtat kërkesa që keni edhe ndaj ZAP-it. 31 janari draft pasqyra financiar, 31 mars pasqyrat vjetore financiare 30 prill, raport vjetor i performancës i audituar dhe shpresoj që gjatë kësaj kohe të merrni vendimin me kohë për auditorët dhe secili institucioni pavarur mund ta bëjë këtë me kohë nëse Kuvendi e kërkon këtë me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu